Project co-funded by the European Union Instrument for Pre-Accession (IPA)

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BASHKIA DURRES**
**Sheshi "Liria", tel/fax : +355-52/ 222310**
**e-mail : info@durres.gov.al**

**Projekti SIMPLE**

## Thirrje per moderator/lehtesues

**Organizimi i Seminarit dhe workshopit nderkombetar me teme : "Multikulturalizmi si nje burim per zhvillimin ekonomik lokal "**
**Afati i fundit per aplikim 29.06.2012 / Ora 16.00**

## Kuadri Ligjor

Ne baze te ligjit Nr 10152, date 28.09.2009 Per ratifikimin e "Marreveshjes se financimit ndermjet Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Komisionit te Komunitetit Europian per Programin e Bashkepunimit Nderkufitar Adriatik te Instrumentit te Ndihmes se para aderimit IPA-Komponenti 2 Bashkepunimi nderkufitar per Shqiperine ", Pika 8 e kesaj marreveshje per " Rregullat e Prokurimit Publik " bazuar ne rregulloret e Komisionit Europian Nr 2342 (2002) si edhe rregullores se Keshillit te Europes Nr 1605(2002) si dhe vendimet e Komisionit (2007)2034 , mbi " Rregullat dhe procedurat per kontratat e sherbimeve paisjeve dhe punimeve te finanacuar nga Buxheti i Pergjithshem i Komunitetit Europian per qellime bashkepunimi me vendet e treta , dhe ne baze te marreveshjes se projektit SIMPLE(kodi 309)i bashkefinancuar nga Programi IPA ADRIATIC CBC , Bashkia Durres publikon thirrjen per ekperte te jashtem.

## Projekti "SIMPLE "

**Projekti SIMPLE** ka per qellim të arrije kohezionin social në vendet e Adriatikut, nëpërmjet forcimit të diversitetit te vlerave kulturore, në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e jetës dhe atraktivitetin e Rajonit te Adriatikut. SIMPLE është një bashkëpunim inovativ institucional dhe ndërtues kapacitetesh që tregon sistemet e mundshme të qeverisjes vendore për adresimin e çështjeve të pakicave me një strategji të gjerë zonë. Partneret Nderkombetare te Niveleve te ndryshme (duke përfshirë Autoritetet Publike, shoqerine civile dhe organizatat e minoriteteve nga Kroacia, Italia, Mali i Zi, Shqipëria, Sllovenia) do të zhvillojnë së bashku një Strategjia te plote dhe Planin e Veprimit të Adriatikut për forcimin e identitetit kulturor te grupeve minoritare.Projekti financohet nga Programi IPA ADRIATIC CBC 2007-2013, nen Prioritetin Nr 1 " Bashkepunimi Ekonomik Social dhe institucional.

Objektivi kryesor i projektit eshte perpunimi i strategjive dhe qasjeve te perbashketa ne vendet e Adriatikut per promovimin e kultures se barazise dhe jo diskriminuese, si nje vlere baze per bashkejetesen paqesore mes qytetareve pa dallim race, feje apo etnie.

Projekti ka identifikuar nder faktoret kryesore te varferise te grupeve minoritare,perjashtimin nga tregu i punes dhe diskriminimin ne kushtet e punes. Kjo situate privon ekonomite lokale nga burime potenciale per kete synohet perfshirja e forces punetore minoritare si nje sektor ne rritje per ekonomite kombetare dhe rajonale.

WP 5 gjithashtu synon të promovojë në mentalitetin e bizneseve të Adriatikut parimet të reja në Menaxhimin e Diversitetit: Persona me kultura të ndryshme në kompanitë e menaxhimit përmirësojnë kapacitetet e reja . Zbatimi i këtij modeli në Shqipëri dhe transferimi i këtij shërbimi në rajone të tjera të Adriatikut janë të mbështetura me aktivitete për ngritje kapacitetesh: çdo partner do të përfshijë aktorët lokale në seminare dhe workshope intensive.

Ne kuader te WP5 Bashkia Durres organizon ne datat **11, 12 Korrik 2012** seminarin dhe workshopin nderkombetar me teme : **"Multikulturalizmi si nje burim per zhvillimin ekonomik lokal "**

**Fushat e ekspertizes se kerkuar:** Moderim , lehtesim

**Kohezgjatja e sherbimit:** 3 dite pune (10,11,12 Korrik 2012)

**<u>Pershkrimi i punes</u>:**

1. Njohje me Projektin SIMPLE , me aktivitetet dhe objektivat e tij, njohje me profilin e pjesmarresve ne seminar dhe me modalitetet e seminarit.
2. Leximi i te gjitha kontributeve te parashikuara ne axhende .
3. Ofrim i sherbimit te moderatorit/lehtesuesit gjate zhvillimit te seminarit dhe worshop-it per dy dite
4. Pergatitja e konkluzioneve te eventit .
5. Dorezimi i nje raporti per sherbimin e ofruar .

**<u>Kualifikimet</u>**

1. Diplome Universitare ne Shkenca Sociale, (Sociologji,Pune Sociale apo fusha te ngjashme .

2. Eksperience pune si moderator dhe facilitues i konferencave, seminareve, workshope, kombetare dhe nderkombetare (reference )

3. Eksperience pune ne fushen akademike, si dhe pjesemarrje ne programe dhe projekte per grupet vulnerabel ( vertetim apo reference ) .

4. Njohje i mire i rregullave dhe procedurave qe zbatohen per fondet e BE dhe me konkretisht te projekteve nga programi IPA Adriatic CBC 2007-2013

**<u>Kriteret e përjashtimit:</u>**

Kandidatët do të përjashtohen nga pjesëmarrja në procedurat e perzgjdhjes nëse:

a) Kane falimentuar , kane ceshtje gjygjesore te hapura, kane aktivitete te pezulluara ose jane subjekt i ndonje procesi gjyqesor.

b)Jane denuar per ndonje veper penale ne lidhje me sjelljen profesionale.

c) Jane shpallur fajtor per sjellje te papershtatshme profesionale .
d) Nuk kane permbushur detyrimet e pagesave te sigurimeve shoqerore apo pagesat e taksave ne perputhje me legjislacionin kombetar .
e) Kane qene subjekt i nje procesi gjyqesor per mashtrim , korrupsion apo perfshirje ne organizata kriminale apo ne nje aktivitete tjeter ilegal qe ndikon ne interesin financiar te Bashkimit Europian .
f)Aktualisht eshte duke iu nënshtruar një ndëshkimi administrativ të përmendur në nenin 96 të Rregullores Financiare (buxheti ) / Neni 99 i Rregullores Financiare).

**Procedura e aplikimit**

Kandidatet e interesuar te cilet permbushin kualifikimet e kerkuara duhet te dorezojne aplikimin e tyre ne perputhje me termat e references te percaktuara ne kete njoftim.

Aplikimet duhet te dorezohen brenda dates 21.06.2012 ora 16.00 dhe duhet te permbajne :

- CV ne formatin Europian
- Kerkese regjistrimi te firmosur
- Leter interesi te firmosur.
- Referenca dhe vertetimet e kerkuara ne termat e references.
- Nje oferte finaciare per sherbimin e ofruar

Aplikimet dorezohen ne adresen :

Aplikim per Eksperte te jashtem /Projekti SIMPLE (kodi 309)
**Bashkia Durres**
**Lgj 1 , sheshi Liria , Durres**
**Tel: +355 52 222310**